

Takim në kuadër të projektit QUADIC

Në kuadër të projektit **QUADIC (Quality Development of International Cooperation and project management)** me koordinator Universitetin “Kadri Zeka”, Gjilan, Kosovë, në Universitetin “Fehmi Agani”, Gjakovë nga dt 29 mars deri në 1 prill, u zhvillua takimi I radhës me përfaqësues të Universiteteve partnere të Shqipërisë, Kosovës dhe atyre evropiane, që janë pjesë e konsorciumit të projektit. QUADIC është një projekt KA2 i Programit Erasmus +, që ka si objektiv primar ngritjen e kapaciteteve institucionale për ndërkombëtarizimin dhe menaxhimin e projekteve në funksion të ngritjes së cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri dhe Kosovë. Ngritja e platformës online si objektiv specifik I projektit, do të lehtësojë menaxhimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale sidomos me universitetet e huaja, mobilitet si dhe projektet ndërkombëtare.





Takimi në kuadrin e QUADIC në Gjakovë, kishte në axhendën e punimeve trajtimin e planit të sigurimit të cilësisë dhe anekseve përkatëse (Quality assurance plan and annexes W.P.8.). Të gjithë partneret prezantuan dhe diskutuan mbi realizimin e objektivave të kësaj pakete pune.

Qëllimi i projektit është krijimi dhe zhvillimi i katërbëdhjetë zyrave plotësisht funksionale të bashkëpunimit ndërkombëtar që do të përfshijnë edhe funksionin e menaxhimit të projekteve.